

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga **Voleks plc** (Volex plc), me seli të regjistruar në Junit C1 Antura, Bond Klouz, Basingstrouk, Hempshajr, RG24 8PZ, Mbretëria e Bashkuar, përmes avokatit Bozhidar Millosheviç nga Shkupi, në seancën e mbajtur në 20.07.2023, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi që i referohet fitimit të kontrollit nga **Voleks plc** (Volex plc), me seli të regjistruar në Junit C1 Antura, Bond Klouz, Basingstrouk, Hempshajr, RG24 8PZ, Mbretëria e Bashkuar mbi **Murat Tixharet Kablo Sanaji A.Sh.** (Murat Ticaret Kablo Sanayi A.Ş.), me zyrë të regjistruar në rr. Beledije Sanaji Sitesi, A Blok, Kocasinan, Bahçelievler, Stamboll, Turqi, **Kablo Ucu Sanaji ve Tixharet A.SH.** (Kablo Ucu Sanayi ve Ticaret A.Ş.), me zyrë të regjistruar në rr. Mahmutbey Jolu Kocasinan Beledijesi Ishani Nr: 7 Bahçelievler, Stamboll, Turqi dhe **Aku Bashi Sanaji ve Tixharet A.SH.** (Akü Başı Sanayi ve Ticaret A.Ş.), me zyrë të regjistruar në rr. Kocasinan Beledije Sanaji Sitesi Nr:1 Bahçelievler, Stamboll, Turqi, nëpërmjet blerjes së pjesëve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës më 27.06.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Komisioni) është dorëzuar një njoftim i përqendrimit nga **Voleks plc** (Volex plc), me seli të regjistruar në Junit C1 Antura, Bond Klouz, Basingstrouk, Hempshajr, RG24 8PZ, Mbretëria e Bashkuar, ku **Voleks plc** do të fitoj kontroll

mbi **Murat Tixharet Kablo Sanaji A.Sh.** (Murat Ticaret Kablo Sanayi A.Ş.), me zyrë të regjistruar në rr. Beledije Sanaji Sitesi, A Blok, Kocasinan, Bahçelievler, Stamboll, Turqi, **Kablo Ucu Sanaji ve Tixharet A.SH.** (Kablo Ucu Sanayi ve Ticaret A.Ş.), me zyrë të regjistruar në rr. Mahmutbey Jolu Kocasinan Beledijesi Ishani Nr: 7 Bahçelievler, Stamboll, Turqi dhe **Aku Bashi Sanaji ve Tixharet A.SH.** (Akü Başı Sanayi ve Ticaret A.Ş.), me zyrë të regjistruar në rr. Kocasinan Beledije Sanaji Sitesi Nr:1 Bahçelievler, Stamboll, Turqi, nëpërmjet blerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Aktivitetet kryesore të **Voleks plc (Volex plc)** janë prodhimi dhe shitja e kablllove elektrike dhe të informacionit, dhe kryen rolin të shoqërisë holding përfundimtare të Grupit të shoqërive Voleks (Volex Group; "Volex Group"). Grupi Volex është i pranishëm në një larmi tregje dhe ka një larmi klientësh, me ekspertizë të veçantë në përpilimin e kablllove, asambletë me kompleksitet të lartë, produktet e qendrës së të dhënave, automjete elektrike dhe elektronikë të konsumit të gjerë. Produktet e Grupit Voleks shiten përmes rrjetit të tyre global të shitjeve dhe përmes shpërndarësve për prodhuesit e pajisjeve origjinale (OEM) dhe shoqëritë e shërbimeve elektronike të prodhimit.

Grupi Voleks nuk ka prezencë të regjistruar në Maqedoninë e Veriut, dhe ka gjeneruar të ardhura të kufizuara nga shitja e kablllove elektrike nga shoqëritë e varura të grupit.

Murat Tixharet Kablo Sanaji A.Sh. (Murat Ticaret Kablo Sanayi A.Ş. ,, **Murat Tixharet**") është një kompani kabllovike që operon në tre kontinente dhe u shërben klientëve në mbi 26 vende. Murat Tixharet prodhon tela elektrikë, kablllo baterie dhe shërben si furnizues i prodhuesve të pajisjeve origjinale në tregjet e transportit publik, ndërtimit, bujqësisë, trajtimit të materialeve, automjeteve të shërbimeve, makinave të pasagjerëve, automjeteve komerciale dhe automjeteve ushtarake.

Përmes shoqërisë së saj të varur në Maqedoninë e Veriut - Murat Viring Systems Macedonia SHPK Ilinden, Murat Tixharet, me seli në Zonën Zhvillimore Industriale Teknologjike Bunarxhik nr. 12.1 dhe 13.1-Shkup 2, Bunarxhik, Ilinden dhe aktiviteti kryesor - prodhimi i telave dhe kablllove të tjera elektronike dhe elektrike, Murat Tixharet menaxhon një objekt prodhues që ndodhet në Zonën Zhvillimore Industriale Teknologjike Shkup 2 dhe në kuadër të këtij objekti prodhon montime kablllosh kryesisht për kompani që operojnë në tregjet e trajtimit të materialeve, transportit publik, automjeteve komunale dhe bujqësisë.

Kablo Ucu Sanaji ve Tixharet A.SH. (Kablo Ucu Sanayi ve Ticaret A.Ş. ,, **Kablo**") prodhon dhe ia shet Murat Tixharetit dhe shoqërive të tjera të grupit, së bashku me palë të tjera të treta në Turqi. Kablo nuk ka prani të regjistruar dhe nuk ka të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Aku Bashi Sanaji ve Tixharet A.SH. (Akü Başı Sanayi ve Ticaret A.Ş.: **Aku Bashi**) prodhon dhe shet terminale të baterive Murat Tixharet dhe shoqërive të tjera në grup, së bashku me palë

të treta në Turqi. Aku Bashi nuk ka prezencë të regjistruar në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka realizuar të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски